

20181632979

LIGJ PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT PËR AKADEMINË E GJYKATËSVE DHE PROKURORËVE PUBLIKË

Neni 1

Në Ligjin për Akademinë e Gjykatësve dhe Prokurorëve Publikë ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 20/15, 192/15 dhe 231/15), në nenin 9-a paragrafi (5) numri "21," shlyhet.

Neni 2

Në nenin 9-b paragrafët (1) dhe (2) ndryshohen si vijojnë:

"(1) Këshilli Drejtues i Akademisë formon Komision për revizion të provimeve të mbajtura të cilat jepen në mënyrë elektronike në përputhje me këtë ligj të përbërë nga pesë anëtarë, si vijon: nga një përfaqësues nga Këshilli Gjyqësor i Republikës së Maqedonisë, Këshilli i Prokurorëve Publikë të Republikës së Maqedonisë, Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë, Prokuroria Publike e Republikës së Maqedonisë dhe Ministria e Drejtësisë. Anëtarët e Komisionit nuk guxojnë të jenë anëtarë të Këshillit Drejtues, Këshillit Programor, Komisionit të Provimit Pranues, Komisionit të Provimit Përfundimtar, mentor, ligjërues ose drejtor i Akademisë.

(2) Komisioni nga paragrafi (1) i këtij neni, mblidhet pas çdo provimi të mbajtur dhe kryen revizion të zbatimit të provimeve të parapara me këtë ligj, duke përfshirë edhe nëse provimet që i kanë mbajtur kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet për dhënien e provimeve në pajtim me këtë ligj, për çfarë paraqet raport te Këshilli Drejtues i Akademisë. Komisioni për revizion të provimeve të mbajtura në punën e tij i shfrytëzon materialet nga provimet e mbajtura, versionet në letër nga testet dhe shembujt praktikë për dhënien e provimit dhe specimenët për kontroll të saktësisë së përgjigjeve të testeve dhe shembullit praktik, si dhe incizimet nga provimet e mbajtura të cilat ruhen në Akademi."

Paragrafi (4) ndryshohet si vijon:

"(4) Gjobë në shumë prej 1.000 deri në 1.500 euro në kundërvlerë me denarë për kundërvajtje do t'i shqiptohet anëtarit të Komisionit nga paragrafi (1) i këtij neni, nëse përcakton parregullsi në zbatimin e provimeve, e kjo nuk është konstatuar në raport te Këshilli Drejtues i Akademisë."

Neni 3

Titulli para nenit 9-v dhe neni 9-v ndryshohen si vijojnë:

"Këqyrje në testet dhe shembujt praktikë

Neni 9-v

Me kërkesë të personave që i kanë mbajtur provimet e parapara me këtë ligj, Akademia u mundëson këqyrje të drejtpërdrejtë në testet dhe shembujt praktikë dhe materialet tjera që kanë qenë pjesë e provimeve."

Neni 4

Neni 11 ndryshohet si vijon:

"(1) Këshilli Drejtues është organ drejtues i Akademisë dhe përbëhet nga nëntë anëtarë.

(2) Katër anëtarë dhe zëvendësit e tyre në Këshillin Drejtues emërohen nga radhët e gjykatësve: një anëtar dhe zëvendësi i tij janë gjykatës të emëruar në seancën e përgjithshme të Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë, dy anëtarë dhe zëvendësit e tyre janë gjykatës

të emëruar nga Këshilli Gjyqësor i Republikës së Maqedonisë dhe një anëtar dhe zëvendësi i tij janë gjykatës të emëruar nga Këshilli Drejtues i Shoqatës së Gjykatësve të Republikës së Maqedonisë.

(3) Katër anëtarë dhe zëvendësit e tyre në Këshillin Drejtues emërohen nga radhët e prokurorëve publikë, si vijon: një anëtar dhe zëvendësi i tij janë prokurorë publikë të emëruar nga Prokurori Publik i Republikës së Maqedonisë, dy anëtarë dhe zëvendësit e tyre janë prokurorë publikë të emëruar nga Këshilli i Prokurorëve Publikë të Republikës së Maqedonisë dhe një anëtar dhe zëvendësi i tij janë prokurorë publikë të emëruar nga Këshilli Ekzekutiv i Shoqatës së Prokurorëve Publikë në Republikën e Maqedonisë.

(4) Anëtar ose zëvendësanëtar në Këshillin Drejtues nga radhët e gjykatësve dhe prokurorëve publikë mund të emërohen gjykatës ose prokurorë publikë me minimum tetë vjet stazh pune si gjykatës respektivisht prokuror publik, me rezultate pozitive në punë.

(5) Ministri i Drejtësisë emëron një anëtar dhe zëvendësin e tij në Këshillin Drejtues nga nëpunësit administrativë udhëheqës në Ministrinë e Drejtësisë me së paku tetë vjet përvojë pune dhe rezultate pozitive në punë.

(6) Anëtar ose si zëvendësanëtar në Këshillit Drejtues mund të emërohet personi i cili i plotëson edhe kushtet në vijim:

- në momentin e emërimit të tij me aktgjykim të plotfuqishëm të mos jetë i dënuar për vepër penale me dënim me burg pa kusht prej së paku gjashtë muajsh,

- në momentin e emërimit me aktgjykim të plotfuqishëm të mos i jetë shqiptuar dënim ose sanksion kundërvajtës për kryerjen e profesionit, veprimtarisë ose detyrës për vepër penale ose kundërvajtje në lidhje me keqpërdorimin e funksionit të gjykatësit ose prokurorit publik.

(7) Në punën e Këshillit Drejtues merr pjesë drejtori i Akademisë (në tekstin e mëtejme: drejtori), pa të drejtë vote."

Neni 5

Neni 12 shlyhet.

Neni 6

Në nenin 15 në paragrafin (2) alineja 2 ndryshohet si vijon:

“- nëse me aktgjykim të plotfuqishëm i është shqiptuar dënim ose sanksion kundërvajtës ndalim për ushtrim të profesionit, veprimtarisë ose detyrës për vepër penale ose kundërvajtje të lidhura me keqpërdorim të funksionit të gjykatësit ose të prokurorit publik."

Në alinenë 3 pika zëvendësohet me lidhëzën “dhe” dhe shtohet alineja e re 4, si vijon:

“-nëse vepron në kundërshtim me dispozitat e rregullave nga sfera e parandalimit të korrupsionit dhe konfliktit të interesave.”.

Neni 7

Në nenin 20 paragrafët (5) dhe (6) ndryshojnë si vijojnë:

"(5) Drejtor, përkatësisht zëvendësdrejtor emërohet personi me së paku tetë vjet stazh pune si gjykatës në gjykata në Republikën e Maqedonisë, në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Maqedonisë, në gjykatë ndërkombëtare ose personi me së paku tetë vjet stazh pune si prokuror publik.

(6) Personi kandidat për drejtor, ose zëvendësdrejtor përveç vetive të larta profesionale dhe rezultateve në punë, duhet t'i plotësojë edhe kushtet në vijim:

- në mënyrë aktive të njohë një nga tri gjuhët më shpesh të përdorura të Bashkimit Evropian (anglisht, frëngjisht, gjermanisht), që dëshmohet me posedimin e certifikatës së pranuar ndërkombëtarisht, të lëshuar nga testues oficiel evropian, anëtar i shoqatës ALTE të testuesve evropianë të nivelit B2 (B2) të CEFR (CEFR), përkatësisht IELTS me 5-6 pikë, FCE, BEK V,

ILEK, IKFE, BULATS, ose APTIS ose TOEFEL PBT së paku 500 pikë, TOEFEL CBT së paku 175 pikë ose TOEFEL IBT së paku 60 pikë ose DELF, TCF, TEF, ose Certifikata Gete, TestDaF,

- në momentin e emërimit me aktgjykim të plotfuqishëm të mos jetë i dënuar për vepër penale me dënim me burg pakusht prej së paku gjashtë muajsh dhe

- në momentin e emërimit me aktgjykim të plotfuqishëm të mos i jetë shqiptuar dënim ose sanksion kundërvajtës ndalim për ushtrim të profesionit, veprimtarisë ose detyrës për vepër penale ose kundërvajtje të lidhura me keqpërdorimin e funksionit gjyqësor ose të prokurorisë publike .".

Paragrafët (7), (8), (9) dhe (10) shlyhen.

Paragrafi (11) bëhet paragraf (7).

Neni 8

Titujt para neneve dhe nenet 21, 22, 23, 24, 25, 26, 27, 28, 29, 30 dhe 31 shlyhen.

Neni 9

Në nenin 35 në paragrafin (2) alineja 2 ndryshon si vijon:

"- nëse me aktgjykim të plotfuqishëm i është shqiptuar dënim ose sanksion kundërvajtës ndalim për ushtrim të profesionit, veprimtarisë ose detyrës për vepër penale ose kundërvajtje të lidhura me keqpërdorimin e funksionit të gjykatësit ose të prokurorit publik,".

Në alinenë 3 pika zëvendësohet me lidhëzën "dhe" dhe shtohet alineja e re 4, si vijon:

"-nëse vepron në kundërshtim me dispozitat e rregullave nga sfera e parandalimit të korrupsionit ose konfliktit të interesave."

Neni 10

Në nenin 37 paragrafi (1) në alinetë 1 dhe 2 fjala "gjashtë" zëvendësohet me fjalën "tetë".

Në alinenë 3 fjala "katër" zëvendësohet me fjalën "tetë".

Paragrafi (6) ndryshohet si vijon:

"Që të emërohet për anëtar përkatësisht zëvendësanëtar të Këshillit Programor, personi duhet t'i plotësojë edhe kushtet në vijim:

- në momentin e emërimit me aktgjykim të plotfuqishëm të mos jetë i dënuar për vepër penale me dënim me burg pa kusht prej së paku gjashtë muajsh,

- në momentin e emërimit me aktgjykim të plotfuqishëm të mos i jetë shqiptuar dënim ose sanksion kundërvajtës ndalim për ushtrim të profesionit, veprimtarisë ose detyrës për vepër penale ose kundërvajtje të lidhura me keqpërdorimin e funksionit të gjykatësit ose të prokurorit publik."

Paragrafi (7) shlyhet.

Neni 11

Në nenin 40 paragrafi (2) alineja 2 ndryshohet si vijon:

"-nëse me aktgjykim të plotfuqishëm i është shqiptuar dënim apo sanksioni për kundërvajtje ndalim për ushtrimin e profesionit, veprimtarisë apo detyrës për veprën penale apo kundërvajtjen lidhur me keqpërdorimin e funksionit të gjykatësit apo prokurorit publik,".

Në alinenë 3 pika zëvendësohet me lidhëzën "dhe" dhe shtohet alineja e re 4, si vijon:

"-nëse vepron në kundërshtim me dispozitat e rregullave nga sfera e parandalimit të korrupsionit dhe konfliktit të interesave."

Neni 12

Në nenin 45 paragrafi (1) fjala "gjashtë" zëvendësohet me fjalën "tetë".

Paragrafi (5) ndryshohet si vijon:

"Ligjërues mund të caktohet personi nga paragrafët (1) dhe (2) të këtij neni i cili i përmbush kushtet në vijim:

- me aktgjykim të plotfuqishëm të mos jetë i dënuar për vepër penale me dënim me burg pakusht prej së paku gjashtë muajsh,

- me aktgjykim të plotfuqishëm të mos i jetë shqiptuar dënim apo sanksion për kundërvajtje ndalim për ushtrimin e profesionit, veprimtarisë apo detyrës për veprën penale apo kundërvajtjen lidhur me keqpërdorimin e funksionit të gjykatësit apo prokurorit publik."

Neni 13

Në nenin 48 paragrafin (1) fjala "gjashtë" zëvendësohet me fjalën "tetë".

Pas paragrafit (4) shtohet paragraf i ri (5), si vijon:

"(5) Mentor mund të zgjidhet personi i cili me aktgjykim të plotfuqishëm nuk është dënuar për vepër penale me dënim me burg pakusht prej së paku gjashtë muajsh dhe me aktgjykim të plotfuqishëm nuk i është shqiptuar dënim apo sanksion për kundërvajtje ndalim për ushtrimin e profesionit, veprimtarisë apo detyrës për veprën penale apo kundërvajtjen lidhur me keqpërdorimin e funksionit të gjykatësit apo prokurorit publik."

Në paragrafin (5) i cili bëhet paragraf (6) fjalët: "paragrafi (1)" zëvendësohen me fjalët: "paragrafët (1) dhe (5)".

Neni 14

Në nenin 57 paragrafi (1) alineja 1 ndryshohet si vijon:

"-të jetë jurist i diplomuar me arsim të lartë të kryer katërvjeçar shkalla VII/I të studimeve juridike apo jurist i diplomuar me 300 kredi të marra sipas Sistemit Evropian për Transfer të Kredive (SETK)."

Alineja 7 ndryshohet si vijon:

"-në mënyrë aktive ta njohë njërën nga tri gjuhët më shpesh të përdorura të Bashkimit Evropian (anglisht, frëngjisht apo gjermanisht), që përcaktohet në kuadër të provimit pranues në Akademi."

Dispozita kalimtare dhe të fundit

Neni 15

Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë, Këshilli Gjyqësor i Republikës së Maqedonisë, Shoqata e Gjykatësve të Republikës së Maqedonisë, Prokurori Publik i Republikës së Maqedonisë, Këshilli i Prokurorëve Publikë i Republikës së Maqedonisë, Shoqata e Prokurorëve Publikë në Republikën e Maqedonisë dhe ministri i Drejtësisë më së voni në afat prej një muaji nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji do të emërojnë anëtarë të Këshillit Drejtues dhe zëvendës të tyre, në pajtim me kushtet e përcaktuara me këtë ligj.

Mbledhjen konstitutive të Këshillit Drejtues do ta konvokojë dhe atë do ta kryesojë anëtari më i vjetër i emëruar i Këshillit Drejtues dhe ajo do të mbahet në afat prej 15 ditësh nga emërimi i anëtarëve dhe zëvendësve të tyre të Këshillit Drejtues në pajtim me këtë ligj.

Këshilli Drejtues në mbledhjen konstitutive do ta miratojë edhe vendimin për shpalljen e konkursit publik për drejtor dhe zëvendësdrejtor në pajtim me kushtet e këtij ligji.

Këshilli Drejtues do t'i emërojë anëtarët dhe zëvendësanëtarët e Këshillit Programor të Akademisë në pajtim me kushtet e këtij ligji më së voni në afat prej tre muajsh nga dita e hyrjes në fuqi e këtij ligji.

Neni 16

Autorizohet Komisioni Juridik Ligjvënës i Kuvendit të Republikës së Maqedonisë të përcaktojë tekst të spastruar të Ligjit për Akademinë e Gjykatësve dhe Prokurorëve Publikë.

Neni 17

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e tetë nga dita e botimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë".